



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 20, date 13/02/2001

**PER
MIRATIMIN E KRIJIMIT TE NDERMARRJES NR.1 TE PUNETOREVE TE
QYTETIT**

Në mbështetje të Ligjit 8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” neni 32, pika ç, Ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal në Republikën e Shqipërisë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë bashkimin administrativ të Ndërmarrjes së Ndriçimit Publik dhe Ndërmarrjes së Kuartallave në Ndërmarrjen e Gjellbërimit dhe Dekorit, duke krijuar një Ndërmarrje të vetme të emërtuar “Ndërmarrja Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit
2. Ndërmarrjet e përfshira në pikën 1 të këtij vendimi me miratimin e këtij vendimi kthehen në drejtori duke ruajtur funksionet dhe qëllimet e tyre parësore
3. Struktura e funksionimit të Ndërmarrjes Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit ndodhet bashkëngjitur këtij vendimi. Efektet financiare mbështetur në miratimin e këtij vendimi fillojnë në 1 Mars 2001
4. Për zbatimin e këtij vendimi, kryerjen e procedurave përkatëse, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike dhe Drejtoria Juridike.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA